

VENDIM
Nr.899, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS VRESHTAS, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Vreshtas, që qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Vreshtas, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.345, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vreshtas, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Vreshtas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vreshtas		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
197,215,216,229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-18	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
19-22 (duke përfshirë dhomën e privatizuar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
31-42	Varrezat publike	Në pronësi
43-86	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

273-292	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
293-296	Prona që përdoren në fushën e furnizimit me ujë	Në pronësi
160-196,198-214,219-227	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
23-30,87-159	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
257-262	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në p[rdorim
263-267,317,330,338,356	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
297	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi